



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1179/2 prot.

Tiranë, më 21. 09. 2021

V E N D I M

Nr. 178, datë 21. 09. 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 165 regj, datë 15.09.2021, të paraqitur nga subjekti ankues, S. T., kundër Bashkisë Pustec dhe Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim (në vijim DPMZSH), në të cilën pretendohet diskriminim për çdo shkak tjetër.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, S. T., në parashtrimet e paraqituara në ankesën e sjellë pranë KMD-së, informon se, referuar shpalljes së publikuar nga ana e Bashkisë Pustec për një pozicion të lirë pune të nivelit të mesëm, Shef Sektori, në Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin (në vijim MZSH), ka paraqitur aplikimin e tij për këtë pozicion.

Sipas tij, referuar Ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” dhe VKM-së nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, Bashkia Pustec, duhet të organizonte procesin e konkurimit për kandidatët të cilën kanë paraqitur interes për emërimin në këtë pozicion pune. Në shkelje të akteve ligjore të sipërcituara, sipas ankuesit, komisioni i ngritur në Bashkinë Pustec, pa zhvilluar procedurat përkatëse e konkurimit, testimin me gojë dhe atë fizik, ka dërguar pranë DPMZSH-së 2 (dy) emrat e kandidatëve të përzgjedhur, të cilët ishin ankuesi dhe shtetasi N. M.

Ankuesi pretendon se, nga ana e Drejtorit të Përgjithëm të DPMZSH-së, si personi i ngarkuar me ligj për emërimin e punonjësve të nivelit të mesëm, Shef Sektori, të MZSH-së, ka përzgjedhur fitues, shtetasin N. M., pra kandidatin tjetër dhe jo ankuesin.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në këto kushte, ankuesi thekson se i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPMZSH-së, me e-mail dhe nëpërmjet mesazheve telefonike, duke i sqaruar ndër të tjera se: *“Po ju shkruaj për arsye se nga ana e Bashkisë Pustec janë shkelur të gjitha procedurat e konkurimit të kandidatëve për të favorizuar kandidatin tjetër.*

1. Janë bërë dy shpallje për vendin vakant, një herë që të mos arrija ti çoja dokumentat dhe njëherë që të plotësonin dosjen e tjetrit sipas dokumentave të mia. Shpalljet mbajnë afatin e fundit të dorëzimit të dokumentave, njëra deri në datë 21.06.2021 dhe tjetra 25.06.2021.

2. Personat që kanë vlerësuar dosjet dhe dy zv. Kryetarët kanë lidhje familjare me kandidatin tjetër dhe sipas ligjit nr. 9367 “Për parandalimin e konflikteve të interesit”, janë në konflikt të hapur interesi si dhe nepotizëm.

3. Nuk është zhvilluar konkursi sipas ligjit dhe rregullores së MZSH-së.

4. Kandidati tjetër nuk plotëson disa nga kriteret e afishuara nga Bashkia.

Për këtë arsye detyrohem t’ju shkruaj juve dhe të kërkoj që ky konkurim të bëhet brenda ligjit dhe të fitojë ai që e meriton. Shpresoj shumë në trajtimin me seriozitet të kësaj çështje pasi do ju drejtohem institucioneve nëse nuk zbatohen kriteret ligjore...”.

Sipas ankuesit, pavarësisht faktit që i është drejtuar me e-mailin e sipërcituar Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së, duke i sqaruar shkeljet e kryera në procesin e konkurimit për punonjës të nivelit të mesëm të MZSH-së dhe përzgjedhjen e kandidatit në konflikt interesi, nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ndërsa, nga ana e Bashkisë Pustec i është sqaruar se është ndjekur procedura e plotë në respektim të legjislacionit dhe për emërimin e kandidatit fitues i është sqaruar se ankuesi duhet t’i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se Bashkia Pustec dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, e kanë vënë në pozita diskriminuese për shkak të konfliktit të interesit që kanë me kandidatin fitues N. M.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri:

- *Të vërtetohet dhe dokumentohet që është i diskriminuar nga Bashkia Pustec dhe nga DPMZSH-së Tiranë.*
- *Të vërtetohet se për shkak të lidhjeve familjare procedura e konkurimit nuk është kryer sipas VKM-së nr. 520/2019.*
- *Të anulohet ky emërim i padrejtë dhe t’i jepet e drejta për konkurim sipas ligjit.*

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 14.09.2021, KMD, i ka kërkuar ankuesit të provojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar dhe të argumetojë lidhjen e tij me trajtimin e pafavorshëm.

- Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nëpërmjet postës elektronike të datës 14.09.2021, subjekti ankues ka dërguar parashtrime, duke sqaruar se shkak i diskriminimit është emërimi dhe favorizimi i kandidatit N. M. për shkak të lidhjeve familjare të tij, në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, por nuk ka dokumentuar shkakun për të cilin ka pretenduar diskriminimin.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar², në nenin 3/1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të tij.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin ankuesi pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat, si moskualifikimi si kandidat fitues për pozicionin Shef Sektori i MZSH-së, pranë Bashkisë Pustec. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga ankuesi lidhen pikërisht me këtë “shkak”.

² Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

Sa i takon pretendimit të tij për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkak” në vetvehte.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁴.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “me çdo shkak tjetër”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

- Referuar citimit sa më lart, ankuesi nuk solli asnjë provë që të dokumentonte “shkakun” e pretenduar prej tij.
- Komisioneri nuk ka evidentuar një karakteristikë personale ose të identifikueshme të ankuesit, e cila, në përputhje me rrethanat e çështjes të kishte shërbyer si shkak për trajtimin e tij të padrejtë apo të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Pustec apo Drejtorisë së

³ Neni 1, i ligjit 10221/2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Përgjithshme të MZSH-së. Në rastin në fjalë, ankuesi ka evidentuar paligjshmëritë e Bashkisë Pustec dhe Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, sipas pretendimeve të tij, por nuk ka arritur të provojë dhe dokumentojë “shkakun” për të cilin ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë me kandidatin tjetër fitues.

- Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim mbetet i karakterit deklarativ, i paprovuar apo mbështetur në prova të tjera, të drejtëpërdrejta apo të tërthorta.
- Në përfundim, vlerësohet se emërimi i kandidatit tjetër si pasojë e konfliktit të interesit për shkak të lidhjeve familjare me 2 (dy) Zv. Kryetarët e Bashkisë Pustec, në vetvete ka të bëjë me mosrespektimin e dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, të ndryshuar, për të cilin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kompetencë në shqyrtimin e tij.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, S. T., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)